



Të punësuar biznesi ka 4-15 punëtor nga periudha 01/2019-04/2022 dhe objektin ka me qira. Subjekti sipas të dhënave në sistem të ATK-së është pajisur me arka fiskale , në Prishtinë me datë 30.12.2021 në Poliklinikë dhe Barnatore, në Poliklinikën në Ferizaj dhe Pejë është pajis me datë 29.06.2022. Tatimpaguesi nuk ka pasur kontrolli paraprake nga ATK-ë. Përgjegdhja e rastit për hapje të procedurës së kontrollit ka rezultuar nga analiza e riskut , dhe objekt kontrolli kanë qenë periudha tatimore 01/2019-04/2022 në TVSH-ë dhe CD-ë 2019-2021, WM, CM dhe WR për periudhat 01/2019-04/2022 dhe kontrolli ka filluar me datë 15.06.2022, duke ofruar formularët zyrtar , si : AU001, AU002, AU003 duke njoftuar tatimpaguesin për hapjes së procedurës së kontrollit dhe intervista fillestare është mbajtur me datë 20.06.2022 .

Kontrolli për vlerësim është bazuar në dokumentacionin e verifikuar të tatimpaguesit, si: llogarinë e arktueshëm dhe të pagueshme për periudhat 2019-2021; kontratat e qirasë ; lista e mjeteve themelore për periudhën 2021 ; deklarimi i transaksioneve të tatimpaguesit (blerje-shitje); pasqyrat financiare 2019-2021; librin e blerjes dhe shitjes, faturat blerëse dhe shitëse për periudhat 01/2019 deri 04/2022 ; stoqet nëpër periudha; listën e pagës për periudhat e kontrollit , informatat nga palët e treta-llogarit e biznesit nga bankat komerciale në Kosovë TEB dhe PCB.

Kontrolli pasi ka analizuar dhe ekzaminuar këto regjistrime kontabël të tatimpaguesit , respektivisht pasi tatimpaguesi nuk ka mbajtur evidencë të shpenzimeve të derivateve siç përshe nenin 4.1 dhe 4.2 i UA nr.03/2015 dhe paragrafi 5.2 i Nenit 36 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë , kontrolli ka pranuar vetëm 50% të shpenzimeve të derivateve. Gjithashtu nuk ka pranuar edhe shpenzimet e servisimit të veturave pasi nuk përputhen të dhënat e automjeteve me fatura.

Po ashtu kontrolli ka konstatuar parregullsi në deklarimin importeve për periudhat e kontrollit 2019-2021, ku janë të përshkruar në raport kontrolli secili DUD-ë i pa regjistruar dhe i pa deklaruar në afatin ligjor , andaj kontrolli ka nuk është pranuar TVSH-ë e zbritshëm sipas nenit 38, paragrafi 2. I Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë .

Po ashtu tatimi shtesë ka rezultuar edhe mos deklarimi i importeve në shitje , ku kontrolli i deklaronte shitje duke ngritur me marzhë sipas marzhës së tatimpaguesit.

Qarkullimi shtesë ka rezultuar edhe nga deponimet në llogarit bankare , në TEB dhe PCB për periudhat e kontrollit 2019-2021 .

Pra, kontrolli pasi ka analizuar dhe ekzaminuar regjistrimet kontabël të tatimpaguesit për periudhat e kontrollit 01/2019-04/2022, ka rezultuar me qarkullimi dhe shtesë në CD-ë në vlerë 12,154.00€, në TVSH-ë në vlerë 9,131.05€ ; WR-1,628.65€ ; CM-154.00€, gjithsejtë në total 24,067.82€ (vlera të marra nga raporti i kontrollit pa sanksione tatimore).

Ankesë-Tatimpaguesi i pa kënaqur me vlerësimin e kontrollit me datë 21.10.2022 ka parashtruar ankesë i cili konteston Raportin e Kontrollit –respektivisht vlerësimin me kontroll sa i përket zhvlerësimin i aseteve dhe veturës , viti 2021 pasi kontrolli nuk ka zbur drejt nenin 15, paragrafi 3.2 dhe 5 i Ligjit nr.05/L-029 për TAK-ë , ku paragrafi 5, parasheh: Një pasuri për aspekte të zhvlerësimin merret parasysh kur vihet për herë të parë në përdorim. Poliklinika është hapur me datë 02/11/2021 datë kur është licencuar nga Ministria. Provë –licenca për lëshimin në punë të poliklinikës, njëhë rit edhe pajisjeve .

Pajisjet para licencimit janë obligative të testohen dhe të bëhet pranimi i tyre nga komisioni i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Agresioni për Mbrojtje nga Rrezatimet .

Po ashtu dëshmi kemi se pajisjet dhe klinika ka qenë funksionale , pagesat e dy punëtorëve, Dhurata Krasniqi dhe Shkurte Bekteshi. Pra pajisja ka qenë funksionale nga periudha tetor/nëntor /2021 , kemi pasur të drejtë edhe për përdorim për pacient.

-Zhvlerësimi i veturës- e cila është blerë për nevoja të biznesit , mirëpo sipas legjislacionit në momentin që është veturë limuzinë nuk pranohet 50% e vlerës së TVSH-së , mirëpo për



qëllime të zhvlerësimit merret vlera e koston 100% dhe kapitalizohet vlera e TVSH-së 50% e cila nuk është e zbritshëm . Me kontrolli për qëllime të zhvlerësimit është marr vetëm 50% e vlerës së koston. Vetura është blerë me 23.06.2021 në Mercom Company deh është prezantuar dokumentacioni inspektores.

DUD-at

Në raportin e kontrollit janë evidentuar dud-at e vitit 2019 si të pa deklaruar në vitin 2019, dud-at nr.4067/30.03.2019;13568/25.09.2019; 75815/29.11.2019

Dud-at 2020-R-6321/09.03.2020; R-14766(18%)/01.07.2019; R-14766(18%)/01.07.2019 (vlerat e ndryshme); dhe R-118101/03.08.2020, gjithsejtë vlera e tyre 5,013.91€,

-Deponimet si pikë kontestuese- për vitin 2019 në vlerë 10,050.00€ në TEB dhe PCB 24,450.00€, në vitin 2020 në TEB-13,910.00€ dhe PCB-17,050.00€; në vitin 2021 në TEB-9,650.00€ dhe PCB-42,610.00€, nga këto deponime kontrolli ka ngarkuar me tatim shtesë e të cilat kanë ardhë si pasojë e tërheqjeve dhe huazimeve familjare.

Tërheqjet që i ka bërë pronari për qëllime të caktuara dhe i ka kthyer ato ndërkohë pjesën e mbetur dhe në deponim në bankomat nuk ka mundësi të përshkruhet as një përshkrim tjetër përveç deponim.

Huazimet nga familjarët janë, si nga bashkëshortja e cila i ka trashëguar nga familjarët që jetojnë jashtë vendit dhe nag bizneset që i ka udhëhequra më parë. Ku pronari i ka marrë për nevoja urgjente të biznesit , për pagesën e kredive , dhe për pagesat e pagave të punëtorëve. Bashkangjitur me ankesë kemi edhe kontrata që Arben Alushaj i ka huazuar mjetet nga bashkëshortja Atifete Alushaj për qëllime biznesi.

Bazuar në sqarimet e sipër shënuara , i propozojmë DA-ve që pas shqyrtimit të argumenteve të ofruara të marrë parasysh dhe të marrë vendim të drejtë duke korrigjuar tatimin shtesë të vlerësuar sipas raportit të kontrollit .

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L-031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit me datë 04.11.2022, në të cilën janë të pranishëm të gjitha palët të ftuara në mënyrë të rregullt.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i autorizuar i biznesit përsëritën argumentet e njëjta të paraqitur në ankesë dhe mbetet pran pretendimeve duke potencuar se kemi katër konteste: 1 Zhvlerësimin e automjeteve , poliklinika ka afaruara nga Nëntori /2021 . Arkën fiskale e ka blerë në fund të 2021 sepse nuk pas në treg, mirëpo kemi pasur paragon bloka. Inspektori nuk i ka marrë për bazë këtë fillim, por ka vlerësuar se nuk kemi afaruar, dhe mjetet –automjetet nuk i ka trajtuar për nevoja të zhvlerësimit nga fillimi i aktivitetit afarist. Kemi veturë që është limuzinë që unë e shfrytëzoj për nevoja të punës brenda territorit dhe jashtë Kosovës. Unë posedoj bilokun e udhëtimit.

Shpenzimet e zhvlerësimit janë mare nga kontrolli vetëm 50% (e vlerës së veturës) e TVSH-së dhe zhvlerësimit.

Dud-at e harruar të pa regjistruar 2018-2020, ata Dud-a si blerje nuk janë regjistruar , mirëpo si shitje i kemi deklaruar. Sa i përket përshkrimit të faturave të hyra (DUD), në përshkrimin e atyre faturave të shitura mund të ndodhë që nuk përshtaten me kontratë që i kemi për të shitur. Këto fatura që janë harruar të regjistrohen si blerje janë bërë shitje dy herë , një herë i kemi shitur ne , njëherë i ka bërë shitje kontrolli.

Kontest që nuk është shfaqur në ankesë por po e shfaqim në seancë , është prezantuar fatura të reja të cilat janë bërë shitje dy herë , për DUD 14776-67 i kemi faturat që janë shitur.

Deponimet janë si pasojë e huazimeve dhe tërheqjeve nga pronari. Çdo deponim që është bërë janë pagesa të punëtorëve , ndaj transfer urgjent dhe për kredi. Nuk kemi mbajtur ditar të arkës , kryesisht janë deponime kesh-ë që i kemi marrë nga bashkëshortja ose nga kursimet e fëmijëve.

-50% të naftës e shfrytëzojmë për gjenerator.

-tatimpaguesi si konteste ka edhe shpenzimet e qirasë, objekti është në emër biznesit ndërsa toka është në emër personal, unë paguaj tatim për qira të objektit Ledi Med paguan Ledi Med.

-Barnatorja ka filluar më vonë me punuar në fillim të 2022, ndërsa poliklinika Nëntor/2021.

Inspektorja në të drejtë e fjalës theksoi: deri sa nuk argumentohen shpenzimet e me dëshmi shfrytëzimit të automjetit ne nuk mund ta njohim ashtu si pretendim tatimpaguesi.

Sa i përket deklarimit në vitin 2021 nuk kemi dëshmi që tatimpaguesi ka shit diçka nuk ka kryer shërbime si rezultat i saj nuk kemi pranuar zhvlerësimin e mjeteve për nevoja të poliklinikës.

-shpenzimet e derivateve janë pranuar vetëm 50%.

-Dudat epa regjistruar 4067(30.03.2019) sipas përshkrimit (pajisje për rreze), sipas faturës së shitjes nuk është precizuar që është shit sipas faturës 4067. Nuk e kam as shifrën as përshkrimin. Nuk kemi muajt me vërtetuar që është shitë për të njëjtin produkt.

Tatimpaguesi muaji 01/2020 ka deklaruar Dud-at 14776; 14766 janë pranuar si blerje pa TVSH-ë, vlera 3,982.00€.

-Deponimet –Ditari të arkës nuk ka pas, por është ngarkuar tatim shtesë.

Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit dhe pretendimeve në ankesës, dëgjimit të dy palëve në seancën dëgjimore, administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës dhe provave të ofruara nga tatimpaguesi, paneli shqyrtues me datë 05.12.2022 vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

-Divizioni i Ankesave konstaton se kontrolli, këtë vendosje - vlerësimin e ka mbështet në nenin 14; 15 dhe 19 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe procedurat ku paragrafi 2 dhe 3 i nenit 19 të ligjit nr. 03-L/222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, parasheh: "Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjyqimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion, përfshirë: librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të tatimpaguesit; librat, regjistrimet, kuponët, faturat, ose informatat tjera përkatëse të personave të tretë; informatat nga personat të cilët mund të verifikojnë saktësinë e deklaratave, librave dhe regjistrimeve të tatimpaguesit; informata të tjera objektive rreth të ardhurave ose shitblerjeve të tatimpaguesit lidhur me detyrimin e tij; informatat e siguruar sipas paragrafin 1 të nenit 14 të këtij ligji; aplikimin e këtij Ligji dhe/apo ligjet e aplikueshme të tatimeve në të ardhura apo TVSh në Kosovë".

-Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, divizioni i ankesave në procedurën e provave të shqyrtimit ka administruar provat relevante dhe atë: raportin e kontrollit të datë 14.09.2022 me nr.13164/2022, njoftim vlerësimeve dhe fletave të punës së kontrollit, deklaratimet e tatimpaguesit, sqarimet shtesë nga inspektorja e kontrollit të datave 15 dhe 17 nëntor, kontratat e prezantuara nga tatimpaguesi me ankesë, ankesën me shkrim të datës 21.10.2022 dhe pretendimeve ankimore në ankesë; nga të njëjtat DA-ja nxjerr konstatimin se: ATK-DR-Prishtina II, ka kryer kontrollin tatimor tek subjekti [redacted] në këto llojet të tatimeve, si: në CD-ë për periudhën 2019-2021; TVSH-ë periudha 01/2019 deri 04/2022, në Tatimin e Mëbajtur në Burim WM); Kontribute Pensionale (CM) dhe Tatim në Qira(WR) të gjitha për periudhat 01/2019 deri 04/2022, e që kontrolli ka rezultuar me tatim shtesë për të gjitha llojet e tatimeve në vlerë prej 24,067.82€ (vlera të marra nga r. i kontrollit pa përfshirë ndëshkimet dhe interesin e kalkuluar sipas ligjit), si rezultat i parregulive të konstatuar me procedurë kontrolli, respektivisht nga trajtimi i



zhvlerësimit, mos mbajtjes së evidencave të shpenzimeve për derivatet e naftës, pasi tatimpaguesi nuk ka mbajtur libër të shpenzimeve të naftës dhe për investimet e kryera tek njësit, andaj kontrolli në mbështetje të nenit 36 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë dhe nenin 56, paragrafi 4.1 dhe 432 të UA nr.03/2015 ka njohur si shpenzim vetë vlerën prej 50% të shpenzimeve. Po ashtu tatimi shtesë ka rezultuar edhe nga mos deklarimi i importeve për periudhat e kontrollit 2019-04/2022 dhe kontrolli importet e pa deklaruara i ka konsideruara blerje pa TVSH-ë dhe të njëjtat janë konsideruara shitje me marzhë të tatimpaguesit, pasi të njëjtat nuk janë argumentuar me faturë të shitjes.

Gjithashtu tatimi shtesë ak rezultuar edhe nga deponimet bankare për periudhat e kontrollit nga informatat e palëve të treta-gjegjësisht llogarita bankarë në TEB dhe PCB, e që nga tatimpaguesi këto të hyra nuk janë deklaruar nga tatimpaguesi, andaj kontrolli i ka konsideruar të hyra shtesë.

Tatimpaguesi konteston në ankesë dhe gjatë seancës dëgjimore këtë vlerësim të kontrollit, gjegjësisht mos pranimin e zhvlerësimit të automjetit veturë dhe mos zhvlerësimin e investimeve të bëra në poliklinikë, DA-ja konstaton se kontrolli ka pranuar shpenzimet e derivateve dhe zhvlerësimin e automjetit prej 50% pasi që tatimpaguesi nuk i ka dokumentuar shpenzimet siç parashohin dispozitat ligjore Nenit 36, paragrafi 4.1 dhe 4.2 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë dhe nenin 56, paragrafi 4.1 dhe 432 të UA nr.03/2015, duke mos ofruar evidencë të veçanta siç parashohin këto dispozita ligjore librin e udhëtimeve, andaj me të drejtë ka pranuar vetë 50% të vlerës së shpenzimeve të ofruara nga tatimpaguesi, pasi që automjetit është veturë e cila mund të përdoret edhe për nevojat jo biznesore dhe private, dhe kur nuk argumentohet me prova materiale duke ofruar evidencë të veçanta siç theksohet në këto dispozita ligjore.

Sa i përket zhvlerësimit të mjeteve në poliklinikë edhe përkundër provave të ofruara nga tatimpaguesi, si licencën nga ministria e shëndetësisë, për lëshimin në punë të poliklinikës, njehë rit e pajisjeve, dhe si dëshmi se poliklinika ka qenë funksionale, pasi kemi ofruar dëshmi për pagesën e dy punëtoreve edhe për kundër këtyre fakteve të ofruara kontrolli nuk ka pranuar zhvlerësimin e mjeteve në poliklinikë, DA-ja vlerëson se e kontrolli nuk ka pranuar zhvlerësimin e këtyre mjeteve pasi që tatimpaguesi nuk e ka dokumentuar me prova relevante me të hyra nga poliklinika siç parasheh neni 15, paragrafi 5, i ligjit nr.05/L-029 për TAK-ë, dispozitë që parasheh: *"një pasuri për aspekte të zhvlerësimit merret parasysh m kur vihet për herë të parë në përdorim"*. Pra, tatimpaguesi nuk e ka dëshmuar me prova se ka filluar aktivitetin në poliklinikat me datë 02/11/2021, pasi që nuk ak deklaruar të hyra në ATK-ë nga poliklinika.

Kontesti i tatimpaguesit për blerjet-DUD-at e pa deklaruar 2019-2022, ku kontrolli i ka deklaruar shitje me marzhë, ndërsa nuk i ka pranuar si blerje DA-ja vlerëson se DUD-at e pa deklaruar nuk i ka pranuar si blerje importet vitit 2019-2020 në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, i Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë, pasi që ka kaluar afati ligjor i deklarimit, ndërsa blerjet-DUD-at për vitin 2021 dhe 2022 që kanë qenë konform nenit 38, paragrafi 2, janë të pranuar nga kontrolli.

Sa i përket Importeve-DUD-ve të pa deklaruar janë konsideruar shitje me marzhë të marrë nga shitjet e tatimpaguesit, ku inspektorja ka përpiluar listën e importeve të pa deklaruara me numër të DUD-ve e, vlera dhe në raport të kontrollit dhe sqarimeve shtesë të datave: 15 dhe 17 Nëntor 2022, pasi që fituarat me përshkrimet e ofruara nga tatimpaguesi nuk korrespondojnë me mallin e përshkruar në importet - DUD-at e tatimpaguesit, dhe për secilin import të pa pranuar kontrolli ka dhënë vlerësim dhe arsyetim konform dispozitave ligjore, si në raport të kontrollit (specifikisht referojuni raportit të kontrollit për secilin import dhe faturë që nuk korrespondojnë sipas përshkrimeve të mallrave).

Kontesti i tatimpaguesi për deponimet në llogari bankare për vitin 201-2022, me arsyetim e këto mjete janë marrë për shkak të eshtërisë financiare të biznesit si dhe janë deponime të pranuar nga bashkëshortja e cila i ka mjete të pranuar nga familjarët që jetojnë jashtë Kosovë, si dhe posedojnë kontratë të huadhënies, në mes bashkëshortes dhe Ledi Med, DA-ja nuk do të marrë për bazë arsyetimet e tatimpaguesit pasi që këto mjete nuk janë transferuar për mes llogarive bankare dhe se janë deponuar kesh-ë në llogari bankare, andaj kontrolli në mbështetje të nenit 19 të UA nr.01/2016 ka ngarkuar tatimpaguesin me të hyra shtesë për deponimet në llogari bankare 2019-2022.

DA-ja konstaton se tatimpaguesi nuk ka argumentuar të kundërtën e vlerësimit zyrtar të ATK-së siç parasheh nenin 19, paragrafi 6 i Ligjit nr.03/L-222, dispozitë që parasheh: "tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është e gabuar dhe barrën për të provuar se shumica e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë".

Andaj, Divizioni i Ankesave vlerëson se pretendimet e tatimpaguesit në ankesë dhe gjatës seancës dëgjimore nuk paraqesin argumente të mjaftueshëm dhe esenciale për të ndryshuar Njoftim Vlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll, prandaj në bazë të gjendjes së faktike, shkresave të lëndës, administrimit të provave dhe në mbështetje dispozitave ligjore, Divizioni i Ankesave konstaton se vendimi mbi Njoftim Vlerësimet e tatimit shtesë të caktuara nga ATK-Drejtoria Rajonale Prishtina II, janë të drejta dhe të bazuara në dispozitat ligjore në fuqi të ATK-së.

Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh kontestin dhe të gjitha provat të cilat gjendën në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 132, pika (2), të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Divizioni i Ankesave e vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", tatimpaguesi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim në Divizionin Fiskal të Divizionit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

**DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË**  
Nr.455/2022 datë 07.12.2022

Vendimi t'iu dorëzohet:

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqësi i Divizionit të Ankesave  
Skender Krasniqi  
Kryesuesi i panelit  
Ramadan Ahmeti

